

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të  
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

**LIGJET DHE TATIMET NË KOSOVË**

**Zgjidhjet**

**P4**



**FLETË PROVIMI**  
Exam Paper

Data 26.10.2019

## CONTENT / PËRMBAJTJA

<b>Pjesa</b>	<b>Maksimumi i dhënë i pikëve</b>	<b>-Kujdes! Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga ShKÇAK-PIKËT E DHËNA</b>
A. Zgjidhje shumëfishe	20	
B. Zgjidhje opcionale	20	
1. Problemi 1	12	
2. Problemi 2	7	
3. Problemi 3	5	
4. Problemi 4	5	
5. Problemi 5	12	
6. Problemi 6	12	
7. Problemi 7	7	
<b>Total</b>	100	

1. Në kuadrin e sistemit tatimor në Kosove janë të përfshira këto tatime dhe procedura:
  - a) Procedurat e ATK-së dhe ARBK-së;
  - b) Tatimi në pronë, TAP, TAK dhe Tvsh;
  - c) Akciza dhe barrierat doganore;
  - d) Asnjëra më lartë.
  
2. Kompania "ART", në Tetor lëshon një notë kreditore për kompaninë "TRA" për shitjet të cilat i ka bërë para dy muajve tek kjo e fundit. Nota kreditore e lëshuar nga "ART" është në vlerë 3,900.40+Tvsh 18%. Për kompaninë "TRA" kjo notë ka ndikim që:
  - a) rrit Tvsh e zbritshme;
  - b) rrit Tvsh e llogaritur;
  - c) zvogëlon Tvsh e zbritshme;
  - d) zvogëlon Tvsh e llogaritur.
  
3. Cilat nga dokumentet burimore duhet të paraqitet në baza mujore në librat e blerjes dhe shitjes së një kompanie:
  - a) Faturat blerëse dhe faturat shitëse;
  - b) Notat kreditore/debitore dhe urdhëresat financiare;
  - c) Kthimet e mallit të shitur/blerë dhe ekstraktet bankare;
  - d) Të gjitha më lartë;
  
4. Rian Krasniqi në muajin Dhjetor 2018 ka pasur rrogën Neto (primare) prej 650.00 Euro. Në Janar të vitit 2018, menaxhmenti vendosi që paga e Rianit të rritet për Bruto vlerë prej 50.00 Euro. Sa do të jetë paga Bruto në Janar të vitit 2019 për Rianin?
  - a) 692.75 Euro;
  - b) 700.00 Euro;
  - c) 784.27 Euro;
  - d) 792.75 Euro.

5. Biznesi individual "FLANDRA", biznes jo i tatueshëm (për qëllime të Tvsh-së), gjatë vitit 2015 ka pasur qarkullim vjetor (janar – dhjetor) në vlerë prej 34,220.00 Euro. Mallrat dhe shërbimet të cilat ofrohen nga "FLANDRA" i nënshtrohen normës standarde të Tvsh-së. A duhet që biznesi individual "FLANDRA" të regjistrohet si person i tatueshëm për Tvsh në vitin 2015?
- a) Po, pasi ka arritur qarkullimin mbi 30,000.00 Euro;
  - b) Jo, pasi baza e qarkullimit pa Tvsh është 29,000.00 Euro;
  - c) Jo, pasi nuk ka arritur qarkullimin mbi 50,000.00 Euro;
  - d) Asnjëra më lartë;
6. Kompania "JONI" importon mall nga Sllovenia. Vlera e faturuar nga kompania sllovene është 5,200 Euro. Kosto e transportit nga Sllovenia në Kosovë është 800 Euro. Autoritet doganore kanë bërë rivlerësim të mallit për të cilën kanë vendosur bazën doganore në vlerë prej 10,000 Euro me transport (pra rivlerësim prej 4,000 Euro). Poashtu sipas kalkulimeve në Dokumentin Unik Doganor (DUD) kjo bazë i nënshtrohet normës 10% taksë doganore dhe normës standarde të Tvsh-së. Kompania "jONI" e ka pranuar bazën e paraqitur nga Dogana. Sa duhet të jetë Tvsh e zbritshme që do të vendoset në librat e kompanisë "JONI"?
- a) 1,080.00 Euro;
  - b) 1,188.00 Euro;
  - c) 1,800.00 Euro;
  - d) 1,980.00 Euro.
7. Kompania DIONI shpk gjatë muajit Gusht 2019 ka pasur dy depo të marra me qera me kontratë mujore: depon në Fushë Kosovë dhe depon në Veternik. Tatimi i mbajtur në burim për qera për depon në Fushë Kosovë është kalkuluar në vlerë prej 55.00 Euro dhe për depon në Veternik në vlerë prej 75.00 Euro. Sa është qeraja bruto e deklaruar për muajin Gusht 2019 që duhet bërë nga DIONI shpk?
- a) 1,300.00 Euro;
  - b) 1,314.44 Euro;
  - c) 1417.00 Euro;
  - d) 1444.44 Euro;

8. Kompania "ANIK" shpk, kryen furnizime të tatueshme për të gjitha produktet që shet. Një klienti afarist i ka lëshuar faturën në vlerë prej 1,234.56 (pa përfshirë Tvsh) dhe i ka ofruar një zbritje/lirim tregtare prej 8% mbi këtë shumë. Sa do të jetë vlera totale e faturës pas zbritjes duke përfshirë edhe Tvsh me normë të reduktuar për furnizimin e bërë?
- a) 1,135.80 Euro;
  - b) 1,143.11 Euro;
  - c) 1,226.65 Euro;
  - d) 1,234.56 Euro.
9. Kompania "NEWBORN" shpk, kryen furnizime të tatueshme për të gjitha produktet që shet. Një klienti afarist i ka lëshuar faturën me produkte të përziera, me normë standarde dhe normë të reduktuar. Vlera e Tvsh-së në këtë faturë ka qenë 150.00 Euro. 70% e kësaj vlere ka qenë me normë të reduktuar dhe pjesa tjetër me normë standarde. Sa është kostoja e mallit të blerë nga ana e klientit?
- a) 833.33 Euro;
  - b) 1,526.50 Euro
  - c) 1,562.50 Euro;
  - d) 1,875.00 Euro;
10. Kompania "FAR" është biznes i cili tatohet sipas skemës reale dhe përbëhet nga 3 ortakë (Flatra, Aroni dhe Riani) pra biznes ortakëri. Sipas legjislacionit tatimor ortakëria /ortakët me 31.12.2018 duhet të deklarojnë pranë ATK-se:
- a) secili ortakë DO;
  - b) secili ortakë deklaratën e PD-së.
  - c) ortakët së bashku një deklaratë të PD-së;
  - d) ortakëria deklaron PD ndërsa ortakët secili DO;

1. Sipas ligjit nr. 05/L-028 Për Tatimin në të Ardhurat Personale, secili person fizik afarist, ortakëri apo grupim i personave, që paguan qira, shton në pagesë edhe nëntë për qind (9%) të tatimit në të ardhurat bruto, në kohën e pagesës apo kreditimit.

E saktë

E pasaktë

2. Sipas ligjit të Tvsh-se, furnizimet me ujë, përveç ujit të ambalazhuar aplikohet norma e reduktuar (8%).

E saktë

E pasaktë

3. Sipas Ligjit Për Administratën Tatimore dhe Procedurat, çdo transaksion nën 500 Euro, i bërë në mes të personave të përfshirë në aktivitete ekonomike kërkohet të bëhet përmes llogarisë bankare.

E saktë

E pasaktë

4. Zyra e Regjistrimit duhet të ruajë 10 vite në arkivat e saj të gjitha shënimet dhe dokumentet, duke përfshirë dokumentet e pranuar ose të regjistruara.

E saktë

E pasaktë

5. Sipas Ligji të Punës, kontrata për një detyrë specifike, nuk mund të jetë më e gjatë se njëqindnjëzet (120) ditë brenda një (1) viti.

E saktë

E pasaktë

6. Shoqëritë tregtare, subjekte të ligjit “Për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim”, duhet të verifikojnë të paktën një herë në 2 vite, ekzistencën dhe vlerësimin e aseteve, të detyrimeve dhe të kapitalit, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe evidencës së tyre mbështetëse nëpërmjet procesit të inventarizimit.

E saktë

E pasaktë

7. Bazuar në Ligjin Për Administratën Tatimore dhe Procedurat, një tatimpagues mundet të dorëzojë një ndryshim deklarate tatimore nëse ai ose ajo më vonë zbulon gabim në deklaratën tatimore të cilën e ka dorëzuar tashmë. Afati për të dorëzuar një ndryshim deklarate është jo më vonë se gjashtë (6) vjet pas datës obligative kur deklarata është dorëzuar fillimisht.

E saktë

E pasaktë

8. Sipas Ligjit Për Administratën Tatimore dhe Procedurat, çdo shumë e tatimit e paguar mbi shumën e detyrimit tatimor, me kërkesën e tatimpaguesit do të kreditohet ndaj detyrimit aktual të tatimpaguesit vetëm për detyrimin tatimore të njëjtë.

E saktë

E pasaktë

9. Sipas Ligjit “Për Shoqëri Tregtare”, shoqëria e regjistruar tregtare ose shoqëria e huaj tregtare, por jo ndërmarrja individuale mund të shfrytëzojnë një emër tjetër tregtar i cili është i ndryshëm nga emri i regjistruar zyrtar.

E saktë

E pasaktë

10. Sipas ligjit nr. 03/L-162 Për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, çdo tatimpagues që bënë pagesa për personat fizik jo-afarist, bujqit, fermerët, grumbulluesit e materialeve recikluese, frutave të malit, bimëve mjekuese dhe të ngjashme me to është i obliguar të mbajë tatimin në burim në shkallën prej pesë përqind (5%) të bruto pagesës, në momentin e pagesës.

E saktë

E pasaktë

11. Furnizim i barnave nuk do të jetë i liruar nga ngarkesa me Tvsh.

E saktë

E pasaktë

12. Sipas ligjit nr. 05/L-028 për Tatimin në të Ardhurat Personale, secili tatimpagues i cili realizon apo akruon të ardhura nga veprimtaritë afariste paguan tatimin çdo tre muaj në një llogari të caktuar nga ATK-ja në një bankë të licencuar nga BQK-ja jo më vonë se dhjetë (10) ditë pas përfundimit të çdo tremujshi kalendarik.

E saktë

E pasaktë

13. Bazuar në ligjin për Administratën Tatimore dhe Procedurat, mospagesa e detyrimit tatimit në kohën e paraparë me ligjet tatimore, bazuar në Ligjin Për Administratën Tatimore dhe Procedurat do të paguajë një interes prej 0.65% në muaj apo pjesë të muajit.

E saktë

E pasaktë

14. Bazuar në ligjin për Administratën Tatimore dhe Procedurat, kërkesa për kreditim ose rimbursimi për një pagesë të tepërt të çfarëdo lloji të tatimit mund të dorëzohet brenda shtatë (7) vitesh nga data kur është paguar tatimi.

E saktë

E pasaktë

15. Sipas ligjit nr. 05/L-029 për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, shpenzimet e përfaqësimit do të jenë të kufizuara në dy përqind (2%) të të ardhurave bruto vjetore.

E saktë

E pasaktë



16. Sipas ligjit nr. 05/L-029 për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, shpenzimet për përmirësimin e pronave me qira të cilat përdoren për aktivitete ekonomike të tatimpaguesit do të kompensohen vetëm 50% e shumës përmes zbritjeve të zhvlerësimit të llogaritura me metodën lineare për periudhën e kohëzgjatjes së qirasë.

E saktë

E pasaktë

17. Sipas ligjit nr. 05/L-028 për Tatimin në të Ardhurat Personale, shpenzimet e trajnimit të paguara nga një punëdhënës për një të punësuar, që lidhen me punën, lejohen plotësisht në vitin në të cilin shpenzimet e tilla të trajnimit kanë ndodhur.

E saktë

E pasaktë

18. Blerjet për të cilat një faturë është lëshuar duhet të futet në librin e blerjeve brenda 5 ditëve pas pranimit të faturës së blerjes. Poashtu, Shitjet për të cilat një faturë e shitjes është lëshuar duhet të futet në librin e shitjeve brenda 5 ditëve pas lëshimit të faturës së shitjes.

E saktë

E pasaktë

19. Puna provuese sipas Ligji të Punës mund të zgjatë më së shumti nëntë (9) muaj.

E saktë

E pasaktë

20. Sipas Ligjit të Tvsh-së, Notë krediti kuptojmë – dokument i lëshuar për qëllim të një rregullimi nga personi i tatueshëm për pranuesin e mallrave ose shërbimeve, pasi që të jetë lëshuar fatura tatimore ose një dokument që shërben si faturë, ku shuma e Tvsh-së së ngarkuar në faturën tatimore ose në dokumentin që shërben si faturë, është me e madhe se obligimi real i Tvsh-së për atë furnizim të tatueshëm.

E saktë

E pasaktë

## **Pjesa C. Pyetjet problemore**

### **Problemi 1**

**12 pikë**

Kompaninë ABC Studio në Mars 2019 ka këto transaksione: shitjet brenda vendit me normë 18% - shuma e tatushme 54,500 Euro, shërbime transportit Prishtinë - Durres 13,200 Euro, blerjet nga bizneset të cilat nuk janë të tatueshëm për Tvsh 8,020 Euro, import nga Franca (kamion) i cili do të përdoret për shërbime transporti i faturuar 22,000 Euro, blerje e një veture në vlerë prej 40,000 Euro nga një biznes vendor i cili konsiderohet si veturë luksi (50% përdorimit për aktivitete të biznesit), notë kreditore e lëshuar me normë të Tvsh-së 18%, vlera e Tvsh-së ishte 200 Euro, shpenzime të rrymes ujit etj të cilat i nënshtrohen normës së reduktuar 525 Euro (shuma e tatushme).

Poashtu gjatë këtij muaji ka pranuar shërbime nga jashtë vendit në vlerë të kostos prej 1,200 Euro të cilat kanë ngarkesë të kundërt. Biznesi ABC studio në fund të muajit Shkurt ka pasur obligim për pagesë në vlerë prej 2,800 Euro.

#### **Kërkohet:**

- a) Sa është obligimi/kreditimi i Tvsh-së për Mars 2019?**

**Zgjidhje: Ekstrakt i deklaratës mujore të Tvsh-së për muajin Mars 2019:**

<b>[TV] FORMULARI I DEKLARIMIT TË TVSH</b>			
Periudha e Deklarimit:	Kolona [ 1]	<b>03</b>	<b>2019</b>
Numri Fiskal:	Kolona [ 3]	<b>600600600</b>	
Emri i biznesit:	Kolona [ 4]	<b>ABC STUDIO</b>	
Adresa e biznesit:	Kolona [ 5]	<b>PRISHTINE, KOSOVE</b>	
Emri i personit kontaktues dhe telefoni:	Kolona [ 6]	<b>Filan Fisteku 044/123123</b>	
		<b>Furnizimet Vlera</b>	<b>TVSH</b>
Eksportet	Kolona [11]	<b>13,200</b>	
Shitjet e tatueshme me normën 18%	Kolona [12]	<b>54,500</b>	<b>9,810</b>
Blerjet që i nënshtrohen ngarkesës së kundërt	Kolona [28]	<b>1,200.00</b>	<b>216</b>
		<b>Kolona [30]</b>	<b>10,026</b>
		<b>Blerjet Vlera</b>	<b>TVSH</b>
Blerjet dhe importet pa TVSH	Kolona [31]	<b>8,020.00</b>	
Importet investive me normë 18%	Kolona [39]	<b>24,200.00</b>	<b>4,356.00</b>
Blerjet vendore me normë 8%	Kolona [45]	<b>525.00</b>	<b>42.00</b>
Blerjet investive vendore me normë 18%	Kolona [47]	<b>20,000.00</b>	<b>3,600.00</b>
Nota debitore e pranuar, nota kreditore e lëshuar me normë 18%	Kolona [53]	<b>1,111.11</b>	<b>200.00</b>
E drejta e kreditimit të TVSH-së në lidhje me ngarkesën e kundërt me normë 18%	Kolona [65]	<b>1,200.00</b>	<b>216.00</b>
		<b>Kolona [67]</b>	<b>8,414</b>
		<b>Kalkulimi Vlera</b>	
Teprica a TVSH-së e bartur nga muaji i kaluar	Kolona [68]	-	
Balanca kreditore e mbetur $69 = ((67+68)-30) > 0$	Kolona [69]	-	
Kërkesa për rimbursim	Kolona [70]	-	
Kreditimi i tvsh-së per muajin pasues $71 = (69-70)$	Kolona [71]	-	
<b>TVSH që duhet të paguhet <math>72 = (30-67-68) &gt; 0</math></b>	Kolona [72]	<b>1,612</b>	

**Sqarim: Importet investive me normë 18%:**

**Import nga Franca (kamion): 22,000 +10% Doganë = 24,200.00**

**Problemi 2**

7 pikë

Kompania ABC shpk ka të punësuar 2 punëtorë. Paga e të punësuarve për muajin Gusht 2019 janë si me poshtë:

Punëtori 1 1,200 Paga Neto

Punëtori 2 620 Paga Neto

**Kërkoet:**

Llogaritni detyrimin e tatimit ne paga dhe KP për muajin Gusht 2019 të këtyre të punësuarve (Kujdes pagat janë neto).

**Zgjidhje:****1. Punëtori: paga Gusht = 1,200 Neto**

	a	b	c=axb	d=a-c	
	Paga e tatueshme	Shkalla e tat.	Tatimi	Paga Neto	Kumulative Paga Neto
1.	80	0%	0	80.00	80.00
2. (1*)	170	4%	6.8	163.20	143.20
3. (2*)	200	8%	16	184.00	427.20
4.(3*)	858.67	10%	85.87	772.80 (3*)	1,200.00
<b>TOTAL</b>	<b>1,308.67</b>		<b>108.67</b>	<b>1,200</b>	

**KP**

Baga bruto  $1,308.67/95\% = 1,377.54$

KP =  $1,377.54 \times 5\% = 68,87 + 68.87 = 137.75$

(1\*) diferenca e pages nga 80 - 250 = 170

(2\*) diferenca e pages nga 250 - 450 = 200

(3\*) diferenca e pages neto  $80+163.20 +184= 427.20$

Paga neto e menaxherit  $1200 - 427.20 = 772.80/90\% = 858.67$

**2. Punëtori 2: paga Janar = 620 Neto**

a	b	c=axb	d=a-c
Paga e tatueshme	Shkalla e tat.	Tatimi	Paga Neto
1. 80	0	0	80.00
2. (1* ) 170	4%	6.8	163.20
3. (2*) 200	8%	16.00	184.00
4.(3*) 214.22	10%	21.42	192.80
<b>TOTAL 664.22</b>		<b>44.22</b>	<b>620.00</b>

**KP**

Baga bruto  $664.22/95\% = 699.18$

KP =  $699.18 \times 5\% = 34.96 + 34.96 = 69.92$

(1\*) diferenca e pages nga 80 - 250= 170

(2\*) diferenca e pages nga 250 - 450= 200

(3\*) diferenca e pages neto  $80+163.20 +184= 427.20$

Paga neto e menaxherit  $620- 427.20= 192.80/90\%= 214.22$

	Paga Bruto	Tatimi	Pensioni	Pensioni	Paga Neto
Punëtori 1	1,377.54	108.67	68.87	68.87	1,200.00
Punëtori 1	699.18	44.22	34.96	34.96	620.00
<b>TOTAL</b>	<b>2,076.72</b>	<b>152.89</b>	<b>137.74</b>	<b>137.74</b>	<b>1,820.00</b>

### Problemi 3

5 pikë

Kompania ANIKI shpk për vitin që përfundon me 31.12.2018 kishte këtë përbërje të fitimit para tatimit:

1. Fitimi nga aktiviteti afarist	180,000
2. Dividenda e pranuar për vitin nga SWISS shpk, Lipjan	70,000
3. Te ardhura nga shitja e asetëve	<u>10,000</u>
<b>Total</b>	<b>260,000</b>

**Sqarim:** Te ardhurat nga shitja e asetëve ka të bejë me shitjen e një kamionete të blerë në vitin 2012, dhe i takonte grupit të dytë të asetëve.

**Kërkohet:**

Të llogaritet tatimi në fitim i kompanisë ANIKI shpk për të ardhurat e tatueshme sipas Ligjit Për Tatimin në të ardhurat e Korporatave për vitin 2018?

**Zgjidhje:**

<b>1. Fitimi nga aktiviteti</b>	<b><math>180,000 \times 10\% = 18,000</math> Euro</b>
<b>3. Te ardhura nga shitja e asetëve</b>	<b><math>10,000 \times 10\% = \underline{1,000}</math> Euro (fitim kapitali)</b>
<b>Obligimi tatimor</b>	<b>19,000 Euro</b>

**2. Dividenda e pranuar prej 70,000 Euro është e ardhur e përjashtuar.**

#### Problemi 4

5 pikë

Kompania "VESA" shpk për vitin 2018 ka pasur një fitim neto 162,000 Euro dhe tatim në të ardhurat e korporatave bazuar në deklaratën përfundimtare në vlerë prej 18,000 Euro.

Parapagimi i kësteve ka qenë në shumë prej 16,000 EUR (metoda historike), diferenca prej 2,000 Euro është paguar me deklaratë përfundimtare me 31 mars 2019.

Bazuar në vendimin e menaxhmentit të kompanisë për vitin 2019 parapagimi i tatimit në të ardhurat e korporatave do të vazhdoje të paguhet bazuar në metodën e "strehës së sigurt" edhe pse është planifikuar sipas këtij buxhetimi se fitimi para tatimit do të jetë rreth 250,000 Euro.

**Kërkohet:**

**Sa do të jetë shuma e një kësti për vitin 2019 për Kompaninë "VESA" shpk?**

**Zgjidhje:**

**Për periudhen vijuese të vitit 2019, paguhet së paku një e katërta (1/4) e 110% të detyrimit tatimor të përgjithshëm të periudhës paraprake ( në këtë rast të vitit 2018), që rezultoi 18,000 Euro.**

**Kalkulimi për këstet e vitit 2019:**

**$18,000 \times 110\% = 19,800 \times \frac{1}{4} = 4,950$  Euro.**

## **Problemi 5**

**12 pikë**

### **Pjesa A**

Kompania "Klerti & Joni" Shpk (person i tatueshëm për Tvsh) më datën 05.02.2016 kishte importuar (Nr DUD: R 123654) nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA) një kamionetë të cilin e kishin blerë për vlerë 8,000.00 Euro (me fatuë). Autoritet doganore kanë bërë rivlerësim të kamionetës për të cilën kanë vendosur bazën doganore të re duke e rivlerësuar prej 4,000 Euro. Poashtu sipas kalkulimeve në Dokumentin Unik Doganor (DUD) kjo bazë i nënshtrohet normës 10% taksë doganore dhe 18% Tvsh. Kompania "Klerti & Joni" Shpk e ka pranuar bazën e paraqitur nga Dogana.

#### **Kërkesa:**

- 1) Si duhet trajtohet në librat e blerjes kjo blerje?**
- 2) Sa është Tvsh e zbritshme me rastin e importimit?**

### **Pjesa B**

Kompania "Klerti & Joni" Shpk në fillim të muajit Janar, viti 2019, vendosi ta shiste kamionetën e blerë më herët nga SHBA. Kompania e ka shitur këtë pasuri një kompanie tjetër me një fitim kapital prej 2,000.00 Euro.

#### **Kërkesa:**

- 1) Si duhet trajtohet në librat e shitjes kjo shitje?**
- 2) Sa është Tvsh e mbledhshme/pagueshme me rastin e shitjes?**
- 3) Sa është vlera e tatimi nga kjo shitje?**



**Zgjidhje:**

**Pjesa A**

**LIBRI I BLERJES**

	<b>Baza</b>	<b>Tvsh</b>
Importet investive me normë 18% :	13,200.00	2,376.00

**Sqarim:**

**Llogaritja 1: Baza për Tvsh:**

**8,000.00 vlera e faturës + 4,000.00 Rivlerësimi = 12,000.00 + 10% doganë = 13,200.00 Euro.**

---

**Pjesa B**

**LIBRI I SHITJES**

	<b>Baza</b>	<b>Tvsh</b>
Shitjet e tatueshme me normën 18%:	5,680.00	2,376.00

**Sqarim:**

**Llogaritja 2: Baza për zhvlerësim, zhvlësimi i akumuluar dhe baza për shitje**

**Baza për zhvlerësim: 8,000.00 (vlera e faturës) + 1,200 (dogana) = 9,200.00**

**Zhvlerësimi:**

**Zhvlerësimi për vitin 2016:  $9,200/5 = 1,840.00$**

**Zhvlerësimi për vitin 2017:  $9,200/5 = 1,840.00$**

**Zhvlerësimi për vitin 2018:  $9,200/5 = 1,840.00$**

**Total Zhvlësimi: 5,520.00**

**Kosto e blerë/vlerësuar: 9,200.00**

**-Zhvlerësimi i akumuluar -5,520.00**

**VNL 3,680.00**

**Baza për shitje :  $VNL + 2,000.00 = 3,680.00 + 2,000.00 = 5,680.00$  + Tvsh**

**Tatimi ne fitim :  $2,000.00 \times 10\% = 200.00$  Euro**

**Problemi 6****12 pikë**

Kompania LURA shpk me seli në Gjakovë, e regjistruar me Tvsh ka prezantuar informatat në vijim sa i përket aktivitetit të saj afarist për vitin e parë:

Përshkrimi	Vlera	Sqarime
Kthimet e shitjes	2,360.00	(përfshirë Tvsh 18%)
Stoqet në fillim të vitit	1,100.00	me kosto
Blerjet	27,140.00	(përfshirë Tvsh 18%)
Pagat	13,100.00	(përfshirë KP të punëdhënësit)
Shp. e zhvleresimit	3,800.00	
Stoqet në fund të vitit	1,300.00	me kosto
Shpenzimet tjera me faturë	2,950.00	(përfshirë Tvsh 18%):
Shpenzimet tjera me faturë	2,100.00	(pa Tvsh):
Shitjet e tatueshme	61,360.00	(përfshirë Tvsh 18%)
Shpenzimet familjare	2,100.00	
Tatimi i paguar gjatë 9 mujorit	320.00	
Pranimi i kredisë nga banka	40,000.00	
Kthimi i kredisë përmes kësteve	5,000.00	
Shpenzimet e interesit dhe tarifat bankare	1,100.00	

Norma e tatimit në fitim është 10%.

**Kërkohet:**

- Të përpilohet pasqyra e të ardhurave sipas ligjit TAK ?
- Sa është marzha Bruto dhe Neto mbi shitjet për periudhën e vitit ?

**Zgjidhje:**

<b>Shitjet</b>	<b>52,000.00</b>	<b>&lt;----- ( 61,360.00/1.18)</b>
<b>Kthimi i shitjeve</b>	<b><u>-2,000.00</u></b>	<b>&lt;----- ( 2,360.00/1.18)</b>
<b>Shitjet Neto</b>	<b>50,000.00</b>	

**KMSH:**

<b>Stoqet në fillim</b>	<b>1,100.00</b>	
<b>+Blerjet</b>	<b>23,000.00</b>	<b>&lt;----- (27,140.00/1.18)</b>
<b>-Stoqet në fund</b>	<b>1,300.00</b>	
	<b><u>22,800.00</u></b>	
<b>Fitimi Bruto</b>	<b>27,200.00</b>	
<b>Shpenzimet e pagave</b>	<b>-13,100.00</b>	
<b>Shpenzimet e zhvleresimit</b>	<b>-3,800.00</b>	
<b>Shpenzimet bankare</b>	<b>-1,100.00</b>	
<b>Shpenzimet tjera (me Tvsh)</b>	<b>-2,500.00</b>	<b>&lt;----- ( 2,950/1.18)</b>
<b>Shpenzimet tjera (pa Tvsh ):</b>	<b><u>-2,100.00</u></b>	
<b>Fitimi para tatimit</b>	<b>4,600.00</b>	
<b>Tatimi @10%</b>	<b><u>-460.00</u></b>	
<b>Fitimi Neto</b>	<b>4,140.00</b>	

**Marzha bruto mbi shitjet:  $25,200/52,000= 48.46\%$**

**Marzha neto mbi shitjet:  $4,140/52,000= 7.96\%$**

**Problemi 7****7 pikë**

Biznesi individual "EON Interier" gjatë vitit 2018 në biznesin e tij kishte pasur fitim para tatimit 12,300.00 Euro. Gjithashtu, "EON Interier" është ortak edhe tek një firmë tjetër e quajtur "EON & ART" OP, e cila gjatë vitit 2018 falë aktivitetit të saj afarist ka arritur të ketë fitim prej 15,600.00 Euro. Këta dy partner kanë rënë dakord që fitimi të ndahet 50:50.

Ndërsa ortaku tjetër "ART" shpk gjatë vitit 2018 kishte pësuar një humbje në shumë prej 1,500.00 Euro. Kjo humbje ishte shkaktuar si pasoj e disa vendimeve të gabuara afariste.

**Kërkesa :**

- a) Sa duhet të paguajë tatim në fitim biznesi individual "EON Interier"?
- b) Sa duhet të paguajë tatim në fitim "ART" shpk?

**Zgjidhje:****a) EON Interier**

**12,300.00 Euro ( fitimi i tij )**

**7,800.00 Euro ( fitimi nga ortakëria (15,600/2))**

**20,100.00 Euro**

0.00 - 960.00	-	0.00 Euro
960.00 - 3,000.00	-	81.60 Euro
3,000.00 - 5,400.00	-	192.00 Euro
5,400.00 - 20,100.00	-	1,470.00 Euro

**Total obligimi për tatim: 1,743.60 Euro**

**b) ART shpk**

**(1,500.00) Euro ( humbje e afariste e ART shpk )**

**7,800.00 Euro ( fitimi nga ortakëria (15,600/2))**

**6,300.00 x 10% = 630.00 Euro**